

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje transformator fuqie per kabinat elektrike

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV : Transformatore 31170000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

**149 230 000 (Njëqind e dyzet e nente milion e dyqind e tridhjetë mijë) leke pa TVSH ose:
konvertuar ne vleren 1 497 225 (Një milion e katerqind e nentedhjetë e shtatë mijë e
dyqind e njëzet e pese) Euro bazuar ne kursin e kembimit date 27.06.2024 (1 EUR =
100.33 ALL).**

Ndarje ne Lote - Nuk ka

Proedura e prokurimit nuk eshte ndare ne Lote, pasi ne si Autoritet Kontraktor e kemi vleresuar se kjo procedure nuk mund te ndahet ne Lote. Kjo per arsye se delegimi dhe autorizimi per realizmin e procedures se prokurimit qe na eshte dhene nga Administratori OSSH sh.a Tirane nuk na eshte dhene i ndare ne Lote. Kemi te bejme me procedure blerje te nje artikulli i cili eshte transformator fuqie per kabina elektrike. Vendi i dorezimit te mallit eshte parashikuar ne Shkoder dhe jo ne disa vende.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2021-2022-2023 të konfirmuara me vule prane administrates tatimore. Operatorët Ekonomike të cilet plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (*dy*) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021-2022-2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për 2024 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Ky kriter të përmbushet nepermjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Gjithashtu ne lidhje me kerkesen per pagesen e taksave vendore referojme se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit per te paraqitur dokumentacionin e shlyerjes se taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë te vertetojne se ushtrojne aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo më e vogel se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën e kerkuar që është brenda vlerës së përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete jo më e vogel se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet .

Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.2.2 Dokumentacioni

Per mallrat objekt prokurimi – Blerje transformator fuqie per kabinat elektrike

Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim te prodhuesit / distributorit per mallin e kerkuar. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, Operatori Ekonomik duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut /eve te prodhuesit/ve per mallrat objekt prokurimi ku te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. *Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

Argumentim: Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e mallrave te prodhuara (lista e mësipërme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen qe ti sherbejne AK-se, per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te OE-ve, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme si aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe cdo element tjeter ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne permbushje te kriterit te mesiperm, Operatoret Ekonomike, duhet te paraqesin deshmi te testimeve zyrtare te kryera, leshuar nga institucione te autorizuar, ose nga prodhuesi, per mallrat e cituar me siper, per te krijuar bindjen se malli i ofruar eshte brenda parametrave te kerkuara. Eshte ne te drejten e AK te kerkoje deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike te vendosura, perpara se AK te beje perzgjedhjen e OE-se fituese. Kjo kerkese eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

4. Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikate te vlefshme qe verteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit te cilesise se tij eshte ne perputhje me ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomike, secili anetar duhet te paraqese certifikatat ISO te sipercituara.

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikaten e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001 eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

5. Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklaron se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve eshte sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara.

Argumentimi: Ky kriter eshte kerkuar pasi vetem prodhuesi mund te vertetoje se produktet e prodhuara kanë në fakt, karakteristikat e deklaruara. Certifikata e sigurimit të cilësisë ka për qëllim të plotësojë deklaratën fillestare apo certifikatën e përshtatshmërisë. Si provë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e produktit, prodhuesi pajiset me certifikatën për cilësinë e sistemit të kontrollit i cili monitoron fabrikimin e produkteve të caktuara. Këto certifikata bazohen në standardet ndërkombëtare ISO 9001: 2000.

6. Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikate ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte kerkuar pasi angazhimi per mbrojtjen e mjedisit kthehet ne nje kriter madhor ne zgjedhjen e nje prodhuesi kurse metoda me e thjeshte dhe me efikase per te shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin eshte zbatimi i nje sistem menaxhimi per mjedisin ne konformitet me standartin nderkombetar ISO 14001.

7. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deklarate konformiteti ku te shprehet qe materialet te kene markim CE.

Argumentimi: Kerkesa per paraqitjen e deklarates se konformitetit per produktet qe kerkohen me siper, eshte nje kerkese e lidhur ngushtesisht me objektin e kontrates dhe duke qene se, Autoriteti Kontraktor eshte perfitues direkt i kontrates objekt prokurimi eshte ne te drejten e tij te garantohet se OE-te pjesemarres i plotesojne kerkesat e cilesise se mallit qe do te ofertohej, rrjeshimisht eshte e drejte e AK-se tu kerkoje ofertuesve qe te paraqesin deklarate per te vertetuar konformitetin prodhimit te produkteve te procedures e prokurimit. Per Autoritetin Kontraktor eshte e nevojshme qe, Operatoret ekonomike gjate ofertimit te tyre te provojne se zoterojne kapacitetet teknike lidhur me deklaraten e konformitetit per artikujt e kerkuara me siper. Kerkesa e mesiperme ka si qellim te siguroje AK-ne, mbi aftesite teknike te OE fitues ne drejtim te permbushjes me sukses te kontrates dhe detyrimeve ne zbatim te saj, konform standarteve te mirepercaktuara ne DST. Ky kriter nuk eshte diskriminues dhe eshte proporcional me objektin e kontrates, si dhe eshte ne zbatim te Nenit 44 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

8. Deri ditën e hapjes se ofertave operatoret ekonomik ofertues duhet te bejne paraqitjen e mostrave prane magazines se institucionit per Transformator fuqie 100/6/0.4 kV Al/Al dhe Transformator fuqie 400/20/0.4 kV Al/Al. Mostrat duhet te jene ne perputhje me specifikimet teknike, sipas te gjitha percaktimeve te bera nga AK. Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja me specifikimet teknike perben kusht per skualifikim. Kostoja e paraqitjes se mostrave mbulohet nga vete operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se duhet te paraqiten mostrat perkatese pasi eshte e nevojshme qe ato te jene ne perputhje me specifikimet teknike.

9. Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permblledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin / Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi:Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

- *Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*
- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë:

Data 05.08.2024 Ora 09.00

vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.